



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005630-8/26, dt. 10.02.2026
Mitrovicë

02-060/01-0005630-8/26
10.02.2026
Mitrovicë - Mitrovica

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë dhe komiteteve tjera; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik

1. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.
2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 - 2.1 Liridona Muharremi,
 - 2.2 Egzon Sadiku,
 - 2.3 Sazan Ramaxhiku
 - 2.4 Ilir Parduzy, dhe
 - 2.5 Xhevdet Ferizi
3. Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
 - 3.1 Të këshillojë dhe konsultohet me Drejtorinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik;
 - 3.2 Inicimi i programeve dhe projekteve zhvillimore komunale;
 - 3.3 Përcjelljen e aktiviteteve të subjekteve ekonomike të biznesit dhe dhënia e këshillave dhe udhëzimeve të nevojshme profesionale;
 - 3.4 Marrja pjesë në projekt-hartimin e planit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës;
 - 3.5 Përgatitjen e planeve konkrete për zhvillimin e industrisë zëjtare;
 - 3.6 Përgatitja e planeve konkrete për zhvillimin e bujqësisë; dhe
 - 3.7 Kontribuon në krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
4. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Komiteti për Zhvillim Ekonomik i dorëzon Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës së tyre për shqyrtim dhe miratim.
6. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Zhvillim Ekonomik është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet: 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të komitetit

